



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Programi: **Bachelor**
Drejtimi: **HISTORI**
Lënda: HYRJE NE HISTORINE E FESE BOTËRORE

Pedagogu: Prof. Dr. Ilira Sulo (Çaushi)
Ngarkesa: 6 ETCS **Frekuenca**, 45 leksione 15 seminare (totali në auditor 45 ore),
Lloji i lëndës Disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)
Programi i studimit : Bachelor në Histori
Viti i III, Semestri i II

PERSHKRIMI:

Lënda synon të pajisë studentët me njohuritë themelore të lindjes dhe evoluimit të besimeve fetara në rang botëror. Për të kuptuar format me të larta të mendimit fetar duhet që të largohesh në kohë tek fillimet e këtij mendimi. Nuk mund të arrijmë të kuptojmë fetë moderne pa gjurmuar më parë historikisht mënyrën se si ato kanë marrë shkallë, shkallë trajtën që ato kanë sot, kjo sepse edhe feja është një dukuri thellësisht njerëzor dhe shoqërore. Studentëve synohet që nëpërmjet ciklit të leksioneve t'u sqarohet se: Si kanë lindur besimet. Ç'funksion kanë patur dhe kanë në jetën tonë të përditshme. Përse disa besime ishin shumë të zhvilluara në një periudhë të caktuar kohore dhe pavarësisht se qëndruan si të tilla për një periudhë mjaft të gjatë, sot janë zhdukur. Kështu studentët do të njihen qysh në fillimet e historisë së fesë, nga fetë e zhdukura, fetë primitive e deri në shfaqjen e feve monoteiste. Përse disa besime janë konservatore dhe të tjera jo. A janë një e re e kohës sonë, ndryshimet e mëdha që duken sot në format dhe praktikat tradicionale të besimit. A janë një e re e kohës sonë, ndryshimet e mëdha që duken sot në format dhe praktikat tradicionale të besimit? Cili është mendimi filozofik në besimet kryesore, etj. do të jenë gjithashtu objekt trajtimi, njohje e diskutimi, përgjatë kësaj lënde.

KONCEPTET THEMELORE ÇELËS:

- Fe, besim, rit, etikë
- Hinduizmi
- Budizmi
- Konfucianizmi, Taoizmi, Shintoizmi
- Besime abrahamike
- Popuj të zhdukur
- Evoluimi,
- Fenomenologji
- Kult



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



TEMAT E LEKSIONEVE

LEX. 1. Origjina e besimeve

Tema trajton çështjen e gjenezës së feve, çfare duhet të kuptojme me fe. shkaqet e shfaqjes, përhapjes, raportet që krijojnë njerëzit me të. Në fokus do të jetë klasifikimi i tyre si; besime të vjetra, antike, të vdekura, të reja, tradicionale, universale etj.,

LEX. 2. Format më të herëshme të besimeve

Në fokus të kësaj teme është njohja me fetë parahistorike, ku do të trajtohen dëshmi të herëshme për lindjen e tyre. Cfarë sollën dhe si ndikuan ato në zhvillim dhe evoluim social e kulturor.

LEX. 3. Klasifikimi i besimeve

Nëpërmjet kësaj teme studentët do të njihen me dy etapat kryesore dhe klasifikimin e besimeve në politeiste dhe monoteiste si dhe krahasimin ndërmjet tyre, shkaqet që çuan në formimin e tyre, dhe një këndvështrim i përgjithshëm mbi ritualet, etikën, zakonet etj,

LEX. 4. Besimet e lashta në Mesopotaminë e vjetër (Sumerët, Babilonasit, Asirianët)

Në këtë leksion do të trajtohet historiku i religjioneve sumeriane, babilonase dhe asiriane, koha kur u shfaqën, sistemi i besimit, koncepti për gjithësinë, kultet, origjina, ceremonitë etj. Mesopotamia vazhdon të ketë një interes të madh në studimin e religjioneve për arsye se atje janë gjetur tekstet më të vjetra për historinë e religjionit.

LEX. 5. Fetë në rajonin e Indisë. Hinduizmi

Në këte cikel leksionesh do të behet një vështrim gjeohistorik mbi Hinduizmin. Shkrimet e para të shenjta,. Tema do të përqëndrohet në prejardhjen, ngjashmërinë e karakteristikave të përgjithëshme, ndikimin e themeluesve në përhapjen e tyre dhe tradicionalizmin. Shkrimet e shenjta, Vedat, Upanishadat, klasifikimi dhe karakteristikat e tyre, rrymat e reja, meditimi etj, do të jenë objekt njohje e studimi në këtë temë. Hinduizmi sot

LEX. 6. Budizmi

Lindja e Budizmit. Studentet do njihen me lindjen, përhapjen dhe filozofinë budiste që është dhe synimi i këtij leksioni. Një vënd të vecantë këtu do të zërë jeta e themeluesit të budizmit, parimet shpirtërore, format e propagandimit të doktrinës, koncepti i të mbinatyreshmes, fraksionet kryesore dhe dallimet mes tyre. Mësimet e Budës. Budizmi pas Budës

LEX. 7. Besimet fetare në Lindjen e largët. Konfucianizmi. Taoizmi. Shintoizmi

Kjo temë do të merret me fenomenin religjioz në Kinë, Japoni, Kore, Vietnam dhe Ishujt e Oqeanisë, të njohura ndryshe me termin Lindja e Largët. Vecanërisht këtu do të ndalemi në historikun e religjionit në Kinë. Elementët religjioz, etika, të jetuarit në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



harmoni me natyrën, meditimi etj, kanë një rëndësi të vecantë kulturore e sociale në këtë rajon, për këtë arsye ato kanë një frymë të dukshme populizmi dhe ndikimi reciprok.

LEX. 8. Jainizmi dhe Skihizmi. Në këtë leksion studentët do të njihen me historikun e Jainizmit dhe Skihizmit. Drejtime kryesore. Dëshmitë e para. Në një vështrim komparistik studentët do të kenë mundësinë të njihen me tiparet e përbashkëta dhe dallimet mes tyre, historikun, përhapjen, dhe ndikimin e tyre në kulturën e traditat indiane

LEX. 9. Fetë e vjetra amerikane. (Aztekët, Majat, Inkatët, Cibcatët)

Tema do të fokusohet në kulturat më të lashta të kontinentit amerikan, gjurmët e tyre dhe arsyet e zhdukjes nga skena historike. Studentët do të njihen me kultet, mitet, tempujt, hyjnitë, format e shkrimeve hieroglifike dhe njohjet astrologjike të tyre.

LEX. 10. Besimet e lashta në Afrikë dhe Arabi

Kjo temë përmbledh lashtësinë e trashëgimisë religjioze të Afrikës dhe Arabisë Veriore, asaj Jugore dhe të Mesme, përshkrimin gjeografik e historik të rajonit, tempujt historikë si Sheba, strukturat religjioze format e politeizmit, dhe kultet kryesore të tyre. Më tej do të kalojmë në Egjipt i cili ka një rëndësi të vecantë pasi është vendi ku janë zbuluar dokumentacionet dhe tekstet më të vjetra në historinë botërore, dhe pas Mesopotamisë, tekstet më të vjetra me tematikë religjioze dhe në Afrikën Nën-Sahariane

LEX. 11. Fetë e vjetra të Europës (Keltët, Zotat e Greqisë, Zotat e Romës, Teutonët)

Bota e zotave në Greqinë e vjetër me prirje henoteiste, dhe pikpamja e një konflikti të vazhdueshëm mes tyre, ishte frymëzimi kryesorë i filozofisë së lashtë i cili mbizotëroi jetën, kulturën, traditat në këtë rajon. Me një politeizëm të përafërt shfaqet edhe religjioni romak. Ky leksion synon studimin e traditave religjioze të vjetra europiane, ndikimin tek njëra-tjetra, konceptin mbi hyjnoren, hyjnizimin e fronit, mitologjitë, konceptin për eskatologjinë dhe rolin e tyre në ndryshimet historike.

LEX. 12. Besimet fetare monoteiste Besimet Abrahamite. Judaizmi

Judaizmi zë një vënd të vecantë në historinë e besimeve monoteiste jo vetëm se është më i vjetri mes tyre por se ai konsiderohet si një bashkim i besimit me etninë (hebraizmin) me të njejtën gjenezë biologjike dhe të njejtën shoqëri fetare. Historia e Bijve të Izraelit, traditat, simbolet, praktikat mistike, fraksionet dhe marrëdhënia me besimet e tjera, janë pjesë e trajtimit në këtë leksion

LEX. 13. Kristianizmi.

Kristianizmi është një prej tre feve të mëdha monoteiste. Leksionet do të trajtojnë Lindjen, evoluimin dhe librat shenjtë. Historia e Kristianizmit do të shihet në gjithë kompleksin e vetme traditat, simbolet, praktikat dhe fraksionet e mëdha në ecure dhe shekujve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



LEX. 14. Islamizmi. Ne shk. VII kemi lindjen e nje besimi te ri monoteist Islamit. Studentet do te njihen me kushtet ne te cilat lindi ky besim. Me figuren kryesore te tij dhe Librin e shejtë. Dallimet qe ka ky besim nga dy besimet e tjera pararendese dhe te perbashketat qe ato paraqisin. Mënyrën e organizimit, traditën praktikat dhe fraksionet e mëdha në shekujt e para pas lindjes së Islamizmit.

LEX. 15. Gnostikët.

Debatet mbi gnostikët sot kanë në thelb kategorizimin/klasifikimin e tyre: a janë fe, rrymë fetaro-filozofike apo tendencë e formuar si rezultat i ndikimeve kulturore brenda traditave fetare, megjithatë ato përbëjnë një aspekt interesant shumë specifik në historinë e religjionit. Në këtë leksion studentët do të njihen me disa prej lëvizjeve gnostike, karakteristikat, historikun, burimet dhe konceptet kryesore.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve

Angazhimi në seminare:

10% e notës

Testi I: në javën e 6-të

10% e notës

Testi II: në javën e 10-të

10% e notës

Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim

70% e notës

Gjithsejt:

100%

LITERATURA:

Teksti bazë ku do të mbështetet kursi

1. Mathhews, W. (2007) World Religions, USA

Një ose dy tekste që janë mjaft afër tematikës së këtij kursi

1. Sarikcioglu, Ekrem. (2007) Historia e Feve, Logosa, Prishtinë.
2. Bouquet, A.C. (2004) Breve Storia delle Religioni, Mondadori, Milano.

Literaturë e rekomanduar

1. Farago, F. (2007) Krishterimi, Judaizmi., Islami dhe Mendimi Perëndimor, Lira, Tiranë.
2. Ecco, U. Accettare La Diversità: Un Manuale Interattivo In Process ([Http://www.tolerance.kataweb.it](http://www.tolerance.kataweb.it))
3. Çausi. I & Filo, Ll. (2002) *Nritja dhe Rënia e Civilizimeve*, Horizont, Tiranë